



Planuar / Ditur / Primesh / Predaba / Received / Delivery	06-05	2022	2	viti / god / year
Organ / Niveli / Org. / Unit	In / Prot / In / Prot / No	Shtypja / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKPMSTICK	2656/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.282/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 24.03.2022 me numër A.nr.282/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/kompensim material" kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.282/2022 e datës 24.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Pejës me datë 16.03.2021 ka marr vendimin me numër të protokollit I.01-116/01-26974/2021 me të cilin vendim ankuesi sistemuar në vendin e punës "Zyrtar Administrativ", pranë Drejtorisë për Bujqësi dhe Hidroekonomi në Pejë është "pezulluar nga puna me pagesë prej 50% të pagës", duke filluar nga data 16.03.2021 gjerë në marrjen e vendimit përfundimtarë nga Gjykata, pastaj Kryetari i Komunës së Pejës me datë 08.07.2021 merr vendimin me numër të protokollit 01-116/01-0068210/2021 me të cilin vendim anulohet vendimi me numër të protokollit I.01-116/01-26974/2021 i datës 16.03.2021 për pezullim nga puna me pagesë prej 50% të pagës për nëpunësin civil gjer në marrjen e vendimit përfundimtarë nga Gjykata.



Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me vendimin e lartë cekur me datë 23.03.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është regjistruar me datë 24.03.2022 me numër të protokollit 1563/2022 me pretendim ankimor për vazhdimin e pagesës me 50% të pagës për gjatë kohës sa është i pezulluar nga vendi i punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.04.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës. Më datë 12.04.2022 organi i punësimit ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë faqe 1/13.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 24.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshim dhe plotësim i aktit të emërimit i datës 06.02.2018; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Pejës i datës 08.07.2021; Akt emërimi i ankuesit i datës 06.02.2017; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimi i datës 16.03.2021 i Kryetarit të Komunës; Libri i protokollit i Komunës së Pejës; Aktvendimi PPRKR.Nr.149/2021 i datës 04.03.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e *jashtëafatshme, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi [redacted] sipas ndryshim plotësimit të aktit të emërimit të datës 07.02.2018 është sistemuar në vendin e punës "Zyrtar Administrativ", pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Ankuesi [redacted] me datë 24.03.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 1563/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor për vazhdimin e pagesës me 50% të pagës për gjatë kohës sa është i pezulluar nga vendi i punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se: **"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"**.

Në lidhje me kërkesën e ankuesit për vazhdimin e pagesës me 50% të pagës për gjatë kohës sa është i pezulluar nga vendi i punës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të provave të lëndës të dërguara nga organi i punësimit konkretisht nga Komuna e Pejës ka konstatuar se ankuesit [redacted] Vendimi me numër të protokollit 01-116/01-



0068210/2021 të datës 08.07.2021 sipas librit të protokollit iu është dërguar në adresën e banimit dhe se me datë 13.07.2021 është pranuar vendimi me numër të rekomandesë 1726765, ndërsa ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrëse për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datë 24.03.2022 *jashtë afatit ligjor*, te përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 127 paragrafi 1, pasi që ankuesit ankuesi ka pasur të drejtë të parashtroj ankesë për vazhdimin e pagesës me 50% të pagës për gjatë kohës sa është i pezulluar nga vendi i punës, gjegjësisht brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur e ka pranuar Vendimin me numër të protokollit 01-116/01-0068210/2021 të datës 08.07.2021.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.282/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësës së Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

